

Vendim nr. 160 datë 11.07.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare

Marsida Xhaferllari, Anëtare

Marjana Semini, Anëtare

në datën 11.07.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 9 (F) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE:

FAZILETE BERDICA

OBJEKTI:

Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-402, datë 07.02.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) për shpërblimin e dëmit moral-ekzistencial të pranishëm në vlerën 300 mijë lekë të reja në muaj që nga dita e largimit nga puna në nëntor të vitit 2009 e në vazhdim, kthimin në punë si administratore, pasi është larguar arbitrarisht dhe pa shënime në librezën e punës, fitimi i munguar në vlerën 1.000.000 (një milion) lekë të reja, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE:

Nenet 15, 17, 18, 43, 44, 49, 55, 59, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, 13 dhe 41 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjo i relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Fazilete Berdica (*kërkuesja*) nga data 01.10.1991 deri në datën 20.11.2009 ka punuar pranë shoqërisë “Ndërmarrja e Trajtimit të Studentëve” sh.a., Shkodër (*punëdhënësi*) në pozicionet e punës si magazinierë konvikti, më pasi si administratore godine dhe së fundmi si magazinierë godine.

2. Kërkuesja në datën 02.11.2009 ka kërkuar ndryshimin e vendit të punës për shkak të kushteve të këqija dhe po në këtë datë ka marrë dy javë raport për shkak të gjendjes shëndetësore. Punëdhënësi, me vendimin nr. 38, datë 20.11.2009, ka refuzuar kërkesën e paditëses për ndryshimin e vendit të punës, duke e cilësuar si të paarsyeshme dhe po me këtë vendim e ka urdhëruar të paraqitej në punë, në të kundërt do të shkarkohej. Në muajin nëntor 2009 kërkuesja është paguar vetëm për 12 ditë pune dhe nuk është paguar për raportet mjekësore.

3. Kërkuesja, duke mos qenë dakord me këtë vendim, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me padi me objekt detyrimin e punëdhënësit për të përcaktuar aktin administrativ të largimit nga puna, rikthimin e menjëhershëm, pagimin e pagave mujore si administratore nga muaji nëntor 2009 e në vazhdim dhe dëmshpërblimin material prej 500 000 lekësh të rinj së bashku me fitimin e munguar dhe dëmin moral në masën 100.000 lekë të rinj. Pas shqyrtimit të padisë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 2817 (8322), datë 16.11.2012, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, duke detyruar punëdhënësin të paguajë dëmshpërblim në masën e 3 pagave mujore për shkak të mosrespektimit të afatit të njoftimit, 5 pagave mujore për shkak të zgjidhjes së menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës dhe 2 pagave mujore për shkak të mosrespektimit të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës, si dhe 8 pagave mujore si shpërblim për vjetërsinë në punë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur rrëzimin e padisë për kërkimet lidhur me rikthimin në punë dhe për dëmshpërblimin moral, duke arsyetuar për këtë të fundit se kërkuesja nuk kishte provuar pretendimin e saj.

4. Në datën 09.01.2014 kërkuesja i është drejtuar sërish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me padi me objekt shpërblimin e dëmit moral-ekzistencial të pranishëm në vlerën 300 mijë lekë të rinj në muaj që nga dita e largimit nga puna në nëntor të vitit 2009 e në vazhdim,

kthimin në punë si administratore, pasi është larguar arbitrarisht dhe pa shënime në librezën e punës dhe fitimin e munguar në vlerën 1.000.000 (një milion) lekë të rinj. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 407 (51-2014-1042), datë 24.03.2014, ka vendosur pushimin e gjykimit, për shkak të largimit të paditëses nga gjykimi. Pas ankimit të kërkueses, Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 1313, datë 23.10.2014, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së rrethit dhe kthimin për rishqyrtim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

5. Në rigjykim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 194 (479), datë 05.02.2015, ka vendosur rrëzimin e padisë me arsyetimin se ky kërkim është gjykuar më parë nga gjykata (vendimi nr. 2817 (8322), datë 16.11.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër), për rrjedhojë përbën gjë të gjykuar. Gjithashtu, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka arsyetuar se edhe nëse rast se nuk do të ndodhej përpara këtij fakti, kërkitimi është i pabazuar në ligj e në prova. Kërkuësja ka paraqitur ankim kundër këtij vendimi.

6. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 378, datë 06.07.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 194 (479), datë 05.02.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

7. Pas rekursit të ushtruar nga kërkuësja, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-402, datë 07.02.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato të parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile.

8. Kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) nëpërmjet shërbimit postar në datën 25.05.2024 me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili është regjistruar në datën 10.06.2024, pas plotësimit të kriterëve sipas nenit 27, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000.

II

Pretendimet e kërkueses

9. **Kërkuësja**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se është cenuar *parimi i barazisë përpara ligjit, i mosdiskriminimit në punë për shkak të gjinisë, gjendjes ekonomike, e drejta e shërbimit mjekësor të paguar, e drejta për punë dhe e drejta për t'u zhdëmtuar*. Largimi nga puna është bërë në mënyrë të padrejtë, për shkak të mosmarrëveshjeve me dy punonjës të tjerë dhe për shkak të mungesës në punë nga data 19.11.2009 deri në datën 01.12.2009, si pasojë e shtrimit në spital, pasi gjendja shëndetësore ishte rënduar nga kushtet e këqija në punë. Dëmet e shkaktuara për

shkak të largimit nga puna mund të riparohen me një dëmshpërblim të arsyeshëm të gjykuar me drejtësi nga Gjykata.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuësit

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

11. Në këtë këndvështrim, Kolegji vlerëson se kërkuësja, si individ, legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, sepse është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhje ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

12. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, kërkuësja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta, duke parashtruar përpara tyre pretendimet e paraqitura në ankimin kushtetues individual. Për rrjedhje, Kolegji vlerëson se ajo nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

13. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se si datë e fillimit të afatit ligjor 4-mujor për paraqitjen e tij, në rastin e procesit gjyqësor, është data e marrjes dijeni efektivisht për vendimin gjyqësor që përbën mjetin e fundit ankimor. Kur objekt i ankimit kushtetues individual është një vendim i Gjykatës së Lartë, si datë e marrjes dijeni për vendimin gjyqësor është ajo kur vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë

gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare të saj ose përmes njoftimit elektronik të tij, kur palët kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit (*shih vendimet nr. 42, datë 19.09.2023; nr. 40, datë 14.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin konkret, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual në datën 25.05.2024, ndërsa vendimi gjyqësor më i fundit që kundërshtohet është dhënë nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në datën 07.02.2024, për rrjedhojë ankimi kushtetues është brenda afatit 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

15. Për sa i përket legjitimitit *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesja ka pretenduar se i janë cenuar disa të drejta dhe parime kushtetuese, si parimi i barazisë përpara ligjit, i mosdiskriminimit në punë për shkak të gjinisë dhe gjendjes ekonomike, si dhe e drejta për punë. Në mbështetje të pretendimeve të saj kërkuesja ka parashtruar si shkaqe mosmarrëveshjet me kolegët, ndryshimin e pozicionit të punës dhe faktin se ishte shtruar në spital për shkak të kushteve të këqija në mjediset e punës. Sipas saj, punëdhënësi nuk ka marrë parasysh kërkesën për ndryshimin e pozicionit të punës dhe pavarësisht paraqitjes së raportit mjekësor për kohën e shtrimit në spital, është paguar për vetëm 12 ditë pune. Sipas kërkueses, të gjitha dëmet e shkaktuara për shkak të largimit nga puna mund të riparohen me një dëmshpërblim të arsyeshëm të gjykuar me drejtësi nga Gjykata.

16. Në këndvështrim të standardeve kushtetuese, Kolegji vlerëson se edhe pse pretendimet për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit, të mosdiskriminimit dhe të së drejtës për punë *prima facie* hyjnë në juridiksionin kushtetues, kërkuesja nuk ka parashtruar asnjë argument kushtetues për të konkretizuar cenimin e tyre, për rrjedhojë pretendimet janë haptazi të pabazuara. Ndërsa kërkimi i saj për vendosjen e një dëmshpërblimi nga Gjykata për të kompensuar dëmin e shkaktuar për shkak të largimit nga detyra ose për shpenzimet mjekësore nuk hyn në juridiksionin kushtetues, për rrjedhojë Kolegji vlerëson se pretendimi nuk mund të merret në shqyrtim.

17. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “a” dhe “e” të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.